



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 51, Datë 17.02.2021

MBI

MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET OST SH.A. DHE KESH SH.A., “PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË BALANCIMIT, KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma “h”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 105, gërma “c” të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 17.02.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 27/5 prot., datë 12.02.2021, të Drejtorive Teknike, mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe shoqërisë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”,

Konstatoi se:

- OST sh.a. me shkresën nr. 613/1 prot., datë 28.01.2021, ka përcjellë për miratim në ERE Kontratën me nr. KESH/Nr.477/1 prot., dhe OST/Nr. 613 prot., ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”.
- Me vendimin nr. 39, datë 06.03.2020, bordi i ERE ka vendosur që, Kontrata KESH/Nr.6651 Prot., dhe OST/Nr.8859 Prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, Kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”, do të shtrijë efektet e përcaktuara në nenin 15 të saj, deri në miratimin nga ERE të Kontratës “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, Kapacitetit

rezervë dhe energjisë balancuese” për vitin 2020, të paraqitur nga palët në mungesë të burimeve të tjera të sigurimit të këtij shërbimi për OST sh.a.”.

- Përmes vendimit nr. 106, datë 02.07.2020, bordi i ERE vendosi “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”.
- Në vijim, me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, bordi i ERE vendosi shtyrjen e afatit të zbatimit nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, pa efekte financiare (DRY RUN) deri në datën 31.03.2021, të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 106, datë 02.07.2020, sipërcituar, si dhe OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijojnë aplikimin e periudhës DRY RUN deri në këtë datë.
- Bordi i ERE me vendimin nr.184, datë 20.08.2018, vendosi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjetik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.
- Për periudhën 2019-2020, vlen të theksohet se shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit për sistemin elektro-energjetik janë siguruar nga shoqëria KESH sh.a.
- Në pikën 2, të dispozitivit të vendimit sipërcituar, është përcaktuar se: *“Çmimet dhe tarifat e përmendura në këtë kontratë nuk janë objekt i miratimit nga ERE”*.
- Për këtë arsye, çmimet e përcaktuara në nenin 9, të Kontrates nuk janë objekt i miratimit nga ana e ERE, pasi këto çmime janë të negociuara dhe të dakordësuara nga vetë palët OST sh.a. dhe KESH sh.a.
- Nga analiza e Kontratës së përcjellë nga ana e shoqërisë OST sh.a. përmes shkresës nr. 613/1 prot., datë 28.01.2021, u konstatua se ajo është e njëjtë me Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjetik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.184, datë 20.08.2018.
- Veç sa më sipër, shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit janë elementë kryesor në garantimin e sigurisë së operimit të sistemit elektroenergjetik shqiptar. Për periudhën deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të bordit të ERE, nr. 106, datë 02.07.2020, për “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, KESH sh.a. si kompani e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik ka qenë dhe vijon të jetë ofrues i këtyre shërbimeve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të bordit të ERE nr.184, datë 20.08.2018 «Mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe

energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.».

2. Kontrata do të shtrijë efektet nga data 1 Janar 2021 deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të bordit të ERE, nr. 106, datë 02.07.2020, për “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”.
3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 01 Janar 2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI